



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN
KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 270 Prot.

Tiranë, më 01.10.2020

VENDIM

Nr 8 datë 01.10.2020

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 për “*Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, VKM nr.469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”,

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së honorarit për anëtarët e Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosove për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën në masën 6 950 lekë për mbledhje sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

PIRO MISHA

Anëtarë

Znj. Ada Ilia Ada Ilia

Znj. Mira Hoxha Mira Hoxha

Znj. Anila Ferizaj Anila Ferizaj

Znj. Floresha Dado Floresha Dado

RELACION PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 756, datë 23.09.2020 “Për funksionimin e komisionit të përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për diasporën”, pika 4 dhe 5 e këtij vendimi thekson se:

- 4. Shpenzimet për mbatëvajtjen e punës së Komisionit, përfshirë udhëtimin, akomodimin dhe dietat, për realizimin e mbledhjeve zyrtare të anëtarëve të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës, për pagesën e recensuesve të teksteve dhe proceseve të tjera në shërbim të procesit, mbulohen nga buxheti i miratuar i Qendrës së Botimeve për Diasporën të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5. Pagesat e pikës 4, të këtij vendimi, propozohen rast pas rasti nga drejtori i Qendrës së Botimeve të Diasporës dhe miratohen nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën.

Për sa më sipër udhëtimet, akomodimet dhe dietat do të mbulohen nga institucionet përkatëse ku bëjnë pjesë Anëtarët e Komisionit.

Referuar legjislacionit në fuqi për sa i përket pagesës së honorareve të anëtarëve të komisionit dhe duke parë fushën e veprimtarisë që ky komision mbulon, baza ligjore për pagesën e tyre është vendimi Nr. 120, datë 27.01.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor” i indeksuar.

Referuar këtij vendimi vlera e honorarit për çdo anëtar të komisionit do të jetë 6 950 lekë për mbledhje.